



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**V E N D I M**

Nr. 68, Datë 26.03.2021

**PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT**

Në mbështetje të nenit 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 189/1/a, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar dhe nenit 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, Këshilli pasi u njoh me kërkesën Nr. Prot 614, datë 10.03.2021 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik i Administrimit dhe i Buxhetit.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin z. Kreshnik Ajazi, si pedagog i jashtëm me kohë të pjesshme, për lëndën “*E drejtë penale e avancuar*”, për vitin akademik 2020- 2021 pranë Kolegjit Universitar të Biznesit, me ngarkesa mësimore 45 orë leksione dhe 23 orë seminare që përbëjnë në total 68 orë, pas orarit zyrtar.
2. Të njoftohen për këtë vendim z. Kreshnik Ajazi dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**



**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHËSHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**



**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR  
VATË STAKAJ**



**ANËTAR  
MOISI DUDA**



**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

